

**SHQIPËRIA MIDIS DY LUFTËRAVE BOTËRORE SIPAS BURIMEVE  
POLAKE**

**TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I SHKENCAVE TË HISTORISË NË DEPARTAMENTIN E  
HISTORISË**

**NGA**

**DONIKA AVDULLI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË**

**PRISHTINË**

**QERSHOR, 2023**

# REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS PËR NIVELIN MASTER

**Mentori:** Prof. Dr. Ibrahim Gashi

**Kandidatja:** Donika Avdulli

**Tema:** *Shqipëria midis dy luftërave botërore sipas burimeve polake*

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i temës: “Shqipëria midis dy luftërave botërore sipas burimeve polake”. Në fillim të këtij punimi është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe janë bërë hulumtime të tjera lidhur me literaturën relevante për temën bosht të çështjes së shtruar për studim.

Punimi në fjalë përmban pesë kapituj:

- ❖ Në kapitullin e parë të titulluar: *Shqipëria gjatë dhe në mbarim të Luftës së Parë Botërore*, kemi trajtuar rrethanat në Shqipëri gjatë kësaj periudhe, duke u bazuar në studimet e Tadeusz Czekalskit për Shqipërinë e asaj periudhe si dhe kemi trajtuar shumë personalitete të cilat gjatë shek: XIX-XX kanë qëndruar në Shqipëri çështje të cilën e ka trajtuar Marian Kałuski. Në vazhdim kemi paraqitur situatën ekonomike, politike dhe kulturore duke u bazuar në artikuj të ndryshëm të botuar në shtypin polak si në gazetën: Pochodnia, Po Pracy, Postęp e shumë të tjera. Po ashtu jemi fokusuar të çështja e Shqipërisë në Konferencën e Paqes si si dhe diskutimet lidhur më kufijtë.
- ❖ Në kapitullin e dytë të titulluar: *Shqipëria në Lidhjen e Kombeve sipas dokumenteve polake*, duke u bazuar kryesisht në dokumente arkivore jemi munduar të sjellim informacione të reja për historiografinë shqiptare. Duke pasur parasysh faktin se Polonia e asaj periudhe nuk ishte e interesuar drejtpërdrejtë për Shqipërinë mund të themi se raportet që sjellin ambasadoret polakë ishin mjaft objektive. Sa i përket Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, ambasadoret raportnin kryesisht për qëndrimin e vendeve që ishin të interesuara drejtpërdrejtë për Shqipërinë, krahas kësaj dokumentet flasin edhe për qëndrimin e Fuqive të Mëdha, ndihmës që realizonte Lidhja e Kombeve për Shqipërinë në vitin 1924, pjesë e të cilës u bë edhe Kryqi i Kuq Polak.
- ❖ Në kapitullin e tretë të titulluar: *Konsolidimi i shtetit shqiptar në planin e brendshëm dhe ndërkombëtar*, kemi analizuar duke u bazuar në burime polake Kongresin e Lushnjës dhe situatën në Shqipëri gjatë viteve 1920-1924. Pasatj jemi përqendruar të lufta e Vlorës e vitit 1920, dhe krejt në fund të këtij kapitulli jemi ndalur dhe kemi

trajtuar situatën në Shqipëri, personalitet e ndryshme gjatë viteve 1920-1924 duke u bazuar në shtypin polakë.

- ❖ Në kapitullin e katërt të titulluar: *Mbretëria Shqiptare 1928-1939, jemi përqendruar të personaliteti i Ahmet Zogut*, gjendjen ekonomike të Shqipërisë si dhe politikën e jashtme. Po ashtu kemi sjellur edhe një raport të Czesław Poznańskit nga vizita e tij në Shqipëri në vitin 1934, dokument ky i cili nga Władysław Wszebor Kulski, i dërgohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Polonisë.
- ❖ Në kapitullin e pestë të titulluar: *Shqipëria gjatë viteve 1939-1945 sipas burimeve polake*, kemi analizuar pushtimin e Shqipërisë nga Italia Fashiste. Po ashtu duke u bazuar në dokumente arkivore kemi gjetur edhe letrën e Ahmet Zogut dërguar kryeministrit polakë në Londër Władysław Sikorski dhe krejt në fund jemi ndalur tek misionet aleate në Shqipëri ku pjesë e tij ishte edhe një oficer polakë i cili ka sjellë një raport të gjatë për: LNÇ-në, Ballin Kombëtar, si dhe Zogistët gjatë asaj periudhe.